LIGJ
Nr. 117/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KONSULENCËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e konsulencës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9310, datë 6.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Projektet nr. 600476, 599174

MARRËVESHJE KONSULENCE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE
(datë 18 gusht 2015)

Sot, më 18 gusht 2015: 1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Klienti) nënshkruan këtë Marrëveshje; me 2. Korporatën Financiare Ndërkombëtare, një organizatë ndërkombëtare e themeluar në bazë të neneve të Marrëveshjes midis vendeve anëtare, duke përfshirë Republikën e Shqipërisë (IFC). Në këtë Marrëveshje termi "Palët" ndonjëherë përdoret për t'iu referuar bashkërisht IFC-së dhe Klientit dhe termi "Pala" ndonjëherë përdoret për t'iu referuar njërës prej tyre veçmas,

duke marrë në konsideratë se:

a) IFC-ja, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, është një organizatë ndërkombëtare qëllimi i së cilës, sipas neneve të Marrëveshjes, është të inkurajojë dhe të ndihmojë për krijimin e kushteve të favorshme për qarkullimin e kapitalit privat, vendës dhe të huaj, për investime produktive në vendet anëtare. IFC-ja ofron shërbime konsulence për të ndihmuar në forcimin e zhvillimit të sektorit privat në Shqipëri, duke u fokusuar kryesisht në fushat e tregtisë, investimeve, mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë, me fokus të veçantë në agrobiznes;

b) Klienti është Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë, Klienti ushtron funksionin e inicimit dhe të ndjekjes së disa politikave, që lidhen me përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore. Klienti, gjithashtu, rregullon fushat e tregtisë, politikën e investimeve, mjedisin e biznesit dhe të konkurrencës në të gjithë sektorët, përfshirë edhe agrobiznesin. Në veçanti, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, si dhe agjencitë dhe zyrat e varura nga këto ministri, do të jenë aktorët kryesorë në këtë proces dhe do të jenë përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve dhe reformave të rëna dakord.

1. Shërbimet e konsulencës

IFC-ja ka rënë dakord të sigurojë shërbimet e konsulencës, të përshkruara në aneksin B (Shërbime konsulence), sipas: 1. Projektit të Tregtisë dhe Investimeve në Agrobiznes të Ballkanit Perëndimor, të zbatuar në Shqipëri; dhe 2. Projektit të Këshillimit mbi Reformën e Treguese për Evropën dhe Azinë

Qendrore (Projekti), duke u bazuar në termat dhe kushtet e parashtruar në këtë Marrëveshje dhe në aneksin A. Klienti është përgjegjës për zbatimin e Projektit. Më hollësisht, do të ngrihet një grup pune për të menaxhuar Projektin në emër të Klientit, të përbërë nga një përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit, një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

2. Financimi i shërbimeve të konsulencës

a) Kostoja totale e shërbimit të konculencës është një milion e shtatëqind e tridhjetë mijë dollarë amerikanë (US$1,730,000). Klienti bie dakord të japë kontributin/et e mëposhtëm/e për të mbuluar këto kosto:

i) Kontributi në para: Klienti do t'i paguajë IFC-së njëqind e dyzet mijë dollarë amerikanë (US$ 140, 000), të cilat do të paguhen në 5 këste, si më poshtë:

A) Kësti 1: 15,000$, të paguhet brenda datës 30 janar 2016, për projektin nr. 599174;

B) Kësti 2: 35,000$, të paguhet brenda datës 31 mars 2016, për projektin nr. 600476;

C) Kësti 3: 40,000$, të paguhet brenda datës 31 mars 2017, për projektin nr. 600476;

D) Kësti 4: 40,000$, të paguhet brenda datës 31 mars 2018, për projektin nr. 600476;

E) Kësti 5: 10,000$, të paguhet brenda datës 31 mars 2019, për projektin nr. 600476;

ii) Kontribut në natyrë: 300,000$ gjithsej për projektin nr. 600476.

b) Çdo pagesë që do t'i bëhet IFC-së sipas kësaj Marrëveshjeje do t'i bëhet IFC-së e plotë dhe në kohën e caktuar, në dollarë amerikanë (me përjashtim të rastit kur IFC-ja specifikon një monedhë tjetër), në fonde menjëherë të disponueshme, pa zbritje për taksat, detyrimet, tarifat apo tatime të tjera (të cilat duhet të merren përsipër nga Klienti), në bankën dhe vendin që IFC-ja cakton herë pas here.

3. Të dhënat e Projektit dhe raportimi i rezultateve

a) Klienti pranon që për operacionet e IFC-së, si një institucion për zhvillim ndërkombëtar, është thelbësore që IFC-ja të jetë e aftë të masë rezultatet e zhvillimit nga projektet që mbështet. Klienti dhe IFC-ja bien dakord që përmbushja e Projektit të monitorohet në bazë të komponentëve dhe duke përdorur treguesit e performancës (treguesit), të specifikuar në aneksin C. Më Shumë informacion për kuadrin e matjes së rezultateve të IFC-së është i disponueshëm në adresën www.ifc.org/results.

b) Në fillim Projekti, Klienti do t'i sigurojë IFC-së informacionet e lidhura me Projektin, të cilat do të jenë të nevojshme për të vendosur bazë/at mbi të cilën/at do të maten më pas treguesit. Më tej, Klienti bie dakord t'i sigurojë IFC-së të dhënat që i çmon të nevojshme për të matur rezultatet e vazhdueshme të zhvillimit të Projektit, duke përdorur treguesit. IFC-ja do t'i mbajë dhe do të përdorë të dhënat dhe informacionet e tjera të dorëzuara nga Klienti në përputhje me politikën e aksesit ndaj informacionit të IFC-së, e cila përshkruhet më hollësisht në pikën 5 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje dhe, në çdo rast për jo më pak se tre vjet pas datës së kësaj Marrëveshjeje, Klienti do të sigurojë të dhëna shtesë që lidhen me përmbushjen e Projektit, të cilat konsiderohen të nevojshme për qëllimin e matjes së rezultateve ose nga stafi i IFC-së, ose nga konsulentët e angazhuar nga IFC-ja.

d) Sigurimi i të dhënave nga Klienti, për qëllimet e treguesve, nuk do ta pengojë Klientin që të raportojë të dhëna të tjera.

4. Raportet dhe dokumentet

Të gjitha raportet dhe dokumentet e përgatitura nga ose me ndihmën e IFC-së mund të shpërndahen nga Klienti sipas nevojave të nëpunësve dhe të punonjësve të saj, por mund të shpërndahet vetëm te palët e treta pasi Klienti t'i ketë kërkuar dhe të ketë marrë pëlqimin me shkrim të IFC-së dhe, më pas, me përfshirjen e refuzimeve sipas kërkesës së IFC-së.

5. Konfidencialiteti/aksesi në informacion

a) Palët bien dakord që Politika e Aksesit ndaj Informacionit e IFC-së (Politika) do të zbatohet për të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe informacionet e tjera që IFC-ja merr nga Klienti ose palët e treta, që lidhen me biznesin e Klientit dhe Projektin. Sipas Politikës, IFC-ja nuk bën publike informacionet financiare për biznesin, pronarët apo informacione të tjera jopublike që i sigurohen IFC-së nga klientët e saj apo palët e treta, pa pëlqimin e këtyre klientëve apo palëve të treta. Sipas Politikës, IFC-ja bën publike disa informacione për aktivitetet e IFC-së. Shembuj të këtyre informacioneve përfshijnë aktivitetet e shërbimeve të konsulencës, raportet e praktikave të mira apo mësimeve të nxjerra, të cilat synojnë të rrisin ndikimin e zhvillimit të iniciativave të IFC-së dhe informacionet e kufizuara specifike të Projektit, si përshkrimet e shkurtra të Projektit, ndikimet e pritshme të zhvillimit dhe rezultatet aktuale. Politika është e disponueshme në faqen e internetit të IFC-së:

www.ifc.org/Disclosure.

b) Sipas Politikës, IFC-ja publikon informacione në lidhje me shërbimet e Konculencës dhe të Projektit, si pjesë e publikimit të të gjitha projekteve të IFC-së (pjesë e të cilave është ky Projekt), nëpërmjet dokumentit të IFC-së për Informacionin e Projektit, të shërbimeve të konsulencës (IPSHK), me anë të vendosjes në *InfoShop*-in e Grupit të Bankës Botërore, zyrat përfaqësuese të përshtatshme të Grupit të Bankës Botërore dhe nëpërmjet faqes së internetit të IFC-së. Teksti i IPSHK-së është bashkëlidhur si aneksi D.

c) IPSHK-ja do të përditësohet të paktën çdo vit, në mënyrë që të reflektojë rezultatet e zhvillimit në përputhje me aneksin C. Në rastin kur IPSHK-ja duhet të rishikohet që të pasqyrojë ndryshimet e materialit në të gjithë përshkrimin e Projektit, ndikimet e pritshme të zhvillimit ose risqet e rritura mjedisore ose sociale, IFC-ja do të njoftojë Klientin me shkrim për përditësimet e propozuara para se të publikohen.

d) IFC-ja dhe/ose anëtarët e tjerë të Grupit të Bankës Botërore mund të kenë lidhur dhe mund të lidhin në të ardhmen, Marrëveshje financiare dhe konsulence me subjektet pjesëmarrëse në sektorin e agrobiznesit në Republikën e Shqipërisë (Sektori). GBB-ja ka politika dhe procedura në lidhje me menaxhimin e konflikteve operacionale të interesit, reale ose të perceptuara, që mund të lindin, duke përfshirë ndarjen e grupeve dhe ruajtjen e informacionit sensitiv të Klientit.

6. Komunikimet

a) Njoftimet. Çdo njoftim, kërkesë ose formë tjetër zyrtare komunikimi, që do të jepet ose do të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe do të konsiderohet i dhënë sipas rregullave kur dëgjohet dorazi, me postë ajrore, shërbime postare ose me faks te marrësi në adresat përkatëse të renditura më poshtë ose në adresat e tjera që përcaktohen në njoftimin pasues me shkrim.

Për Klientin:
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Adresa për komunikime: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Bashkim Sykja, drejtor, Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes
Për IFC-në:
Adresa për komunikime:
International Finance Corporation
Praterstrasse 31
1020 Vienna
Austria
Në vëmendje të: Lisa Kaestner
Menaxhere, Departamenti i Tregtisë dhe Konkurrueshmërisë
Faks: +43 12170 797

b) *E-mail*-et. Palët pranojnë që për periudhën e shërbimeve të konsulencës, ato mund të komunikojnë me njëra-tjetrën me anë të *e-mail*-it. Megjithatë, meqë këto forma komunikimi nuk mund të garantohen si të sigurta ose pa gabime ose viruse, Palët bien dakord që çdo njoftim apo formë komunikimi zyrtar që kërkohet sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të dërgohet në përputhje me nënseksionin "a" më sipër, me qëllim që të jetë efektive.

7. Versioni në gjuhën angleze ka përparësi.

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Palët pranojnë dhe bien dakord që versioni anglisht i këtij dokumenti do të jetë versioni rregullues dhe në të gjitha rastet do të ketë përparësi ndaj përkthimit në gjuhën shqipe, i cili jepet vetëm për referencë.

8. Marrëveshje e plotë dhe kopjet.

a) Kjo Marrëveshje, bashkë me të gjitha anekset e saj, përbën të gjithë Marrëveshjen ndërmjet Palëve dhe zëvendëson të gjitha Marrëveshjet, mirëkuptimet dhe rregullimet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet tyre në lidhje me temën e parashtruar këtu. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohet e pavlefshme, jo e ligjshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria e të gjitha dispozitave të tjera nuk do të cenohet në asnjë mënyrë dhe kjo Marrëveshje do të interpretohet dhe do të jetë e zbatueshme sikur kjo dispozitë e pavlefshme, joligjore ose e pazbatueshme të mos ishte përfshirë në këtë Marrëveshje.

b) Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në disa kopje, ku secila prej tyre është origjinale, por të gjitha përbëjnë të njëjtën Marrëveshje.

c) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme të miratimit.

Në dëshmi të kësaj, klienti dhe IFC-ja kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre përkatës në datën e shkruar fillimisht më sipër.

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES

Nga: _____
Emri: Arben Ahmetaj
Titulli: Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

INTERNATIONAL FINANCE CORPORATION

Nga: _____
Emri: Thomas Lubeck
Titulli: Menaxhet

ANEKSI A
TERMAT STANDARDË

1. Përdorimi i konsulentëve

IFC-ja mund të vendosë që disa detyra, që lidhen me zbatimin e shërbimeve të konsulencës, mund të kryhen më mirë nga një konsulent i jashtëm (Konsulenti), rast në të cilin IFC-ja mund të zgjedhë një Konsulent në përputhje me udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për prokurimet. Konsulenti do të raportojë drejtpërdrejt tek IFC-ja për të gjitha çështjet. Me kërkesën tonë, Klienti do t'i sigurojë menjëherë Konsulentit të gjithë dokumentacionin, informacionin dhe asistencën që Konsulentit mund t'i nevojitet për të përmbushur detyrat e tij në një mënyrë të shpejtë dhe efektive.

2. Përfaqësimi i pikëpamjeve të IFC-së dhe përdorimi i emrit, shenjave dhe logove të IFC-së

a) Klienti bie dakord që nuk do të përfaqësojë ose nuk do të lejojë përfaqësimin e opinioneve të IFC-së, pa miratimin paraprak me shkrim të IFC-së ose të përdorë, ose të lejojë përdorimin e emrit, shenjave apo logove të IFC-së në reklama, literaturën promocionale apo informacione, pa miratimin paraprak me shkrim të IFC-së, dhe nëse IFC-ja nuk jep miratimin e saj për të përdorur emrin, shenjat dhe logot rreptësisht në përputhje me lejen e dhënë dhe me përfshirjen e këtyre refuzimeve, sipas kërkesës së IFC-së.

b) Palët përfshijnë atributet dhe refuzimet specifike në materialet e reja të përgatitura në lidhje me këtë Marrëveshje, që pikëpamjet e shprehura nga autori/ët nuk pasqyrojnë domosdoshmërish ato të IFC-së, bordit të saj të drejtuesve apo qeverive që përfaqësojnë.

3. Mospranimet

a) Ndërsa IFC-ja do të kryejë një punë të zellshme për kryerjen e shërbimeve të konsulencës, IFC-ja nuk bën përfaqësim apo garanci të hapur apo të nënkuptuar të shkallës së suksesit që mund të arrihet për zbatimin e rekomandimeve që përmbahen në çdo produkt pune të përgatitur nga ose me asistencën e IFC-së ose për zbatimin e Projektit.

b) Klienti bie dakord që i gjithë informacioni i njoftuar ose që do t'i njoftohet IFC-së nga Klienti në përputhje me termat e kësaj Marrëveshjeje, është i vërtetë dhe i saktë. IFC-ja do të bazohet në të dhe nuk do të verifikojë në mënyrë të pavarur saktësinë dhe plotësinë e informacionit që Klienti i jep IFC-së, dhe është përgjegjësia e Klientit që të informojë IFC-në për të gjitha ndryshimet në informacionin e paraqitur IFC-së.

c) Pa kufizim në imunitetin dhe privilegjet e IFC-së, sipas neneve të Marrëveshjes ose konventës ndërkombëtare ose ligjeve të tjera të zbatueshme, IFC-ja nuk është përgjegjëse ndaj Klientit apo Palëve të treta për humbjet, koston, dëmin apo detyrimet që Klienti apo palët e tjera do të pësojnë si rezultat i shërbimeve të konsulencës, vetëm nëse shkaktohen nga neglizhenca flagrante ose nga shkelje serioze të qëllimshme nga ana e IFC-së. Pavarësisht elementeve të përmendura në këtë Marrëveshje, përgjegjësia e IFC-së ndaj Klientit, nëse ka, nuk përfshin dëmet, humbjet e fitimit apo humbjen e mundësive që janë indirekte, ndëshkuese apo me pasojë, dhe as nuk tejkalon shumën e pagesave të marra nga IFC-ja për llogarinë e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) Palët pranojnë dhe bien dakord se qëllimi i kësaj Marrëveshjeje nuk është të krijojë një partneritet, ndërmarrje të përbashkët apo marrëveshje të ngjashme, ku Palët të kenë detyrime bashkërisht ndaj palëve të treta ose për qëllime të tjera. Asgjë në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje nuk do të përbëjë një

angazhim nga ana e IFC-së për të siguruar financim për Klientin në lidhje me Shërbimet e Klientit, Projektin apo ndryshe.

4. Vonesat

Përveç ndonjë detyrimi për të paguar shumat e kërkueshme sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, asnjë nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse ndaj tjetrës për vonesat apo mospërmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje në masën kur këto vonesa apo mospërmbushje lindin nga shkaqe jashtë kontrollit të tyre, duke përfshirë zjarrin, përmbytjet, fenomene natyrore, akte apo rregullore të nivelit qeveritar apo mbikombëtar, luftëra, kryengritje, greva, bllokime apo konflikte indus-triale.

5. Të drejtat e pronësisë intelektuale

Të drejtat e Pronësisë Intelektuale për secilën nga Palët në raportet, studimet, analizat, procedurat, planet apo dokumentet e tjera të IFC-së, që ekzistonin më parë, të përdorura nga IFC-ja në lidhje me Projektin do t'i mbeten asaj Pale. Të drejtat e pronësisë intelektuale për materialet e reja, të përgatitura apo të krijuara nga IFC-ja ose Konsulenti/ët, do t'i përkasin IFC-së, me kusht që Klientit t'i jepet një licencë joekskluzive, e përhershme dhe pa tarifën e së drejtës së pronësisë intelektuale për të krijuar, kopjuar, shfaqur, shpërndarë, publikuar dhe krijuar punë derivuese të të gjithë apo një pjese të materialeve të reja, në bazë të të drejtave të palëve të treta. "Materiale të reja" u referohet të gjitha materialeve që përgatiten apo krijohen në lidhje me shërbimet e konsulencës dhe të gjitha të drejtat e pronës intelektuale, duke përfshirë për qëllim qartësie, të gjitha punët derivuese, që rezultojnë nga materialet e reja.

6. Parimet mjedisore dhe të zhvillimit social

Klienti pranon që IFC-ja i ka siguruar Klientit një kopje të kuadrit të qëndrueshmërisë së IFC-së, e cila mund të gjendet edhe në adresën http://www.ifc.org/sustainability, e cila përfshin standardet e performancës, që gjenden në faqen e internetit të IFC-së www.ifc.org/enviro. Klienti bie dakord që IFC-ja të drejtohet nga ky kuadër për zbatimin e shërbimeve të konsulencës.

7. Antimashtrimi dhe antikorrupsioni

IFC-ja lufton për parandalimin e mashtrimit dhe të korrupsionit në aktivitetet e saj dhe ndërmerr veprime serioze në përgjigje të rasteve të sjelljeve të tilla. Informacion më i detajuar për kuadrin e sanksioneve dhe masave kundër tyre mund të gjendet në faqen e internetit të IFC-së (http://www.ifc.org/anticorruption).

8. Përfundimi

a) Secila prej Palëve ka të drejtën të përfundojë këtë Marrëveshje, pa shkak, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së hyrjes në fuqi të përfundimit.

b) Pas 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike të dhënies së njoftimit paraprak me shkrim, secila prej Palëve mund të përfundojë këtë Marrëveshje si rezultat i mospërmbushjes nga ana e palës tjetër të detyrimeve të përshkruara në të.

c) IFC-ja mund të pezullojë ose të përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë që e çmon të arsyeshme, pas konsultimeve me Klientin, që Projekti nuk mund të zbatohet në një mënyrë që do të ishte kryesisht në përputhje me kuadrin e qëndrueshmërisë së IFC-së dhe me standardet e performancës së IFC-së.

d) Në rastin e përfundimit të Marrëveshjes, IFC-ja nuk do të ketë pretendime ndaj Klientit për shkak të përfundimit, përveç pagesës që Klienti i detyrohet IFC-së për të gjitha pagesat që i detyrohet sipas kësaj Marrëveshjeje, duke zbritur shumat e paguara më parë nga Klienti në llogarinë përkatëse.

e) Asgjë nga elementet që janë përfshirë në nënseksionet "b" ose "c" më sipër, nuk interpretohet si heqje dorë nga marrja e masave të mundshme sipas ligjeve të zbatueshme.

Pavarësisht nga përcaktimet këtu apo diku tjetër në këtë Marrëveshje, në kundërshtim të tyre, dispozitat e seksioneve të mëposhtme do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të kësaj Marrë-veshjeje: seksionet: 3 (Të dhënat e Projektit dhe raportimi i rezultateve); 4 (Raportet dhe dokumentet); 5 (Konfidencialiteti/aksesi në informacion); dhe 7 (Versioni në gjuhën angleze ka përparësi), në pjesën kryesore të kësaj Marrëveshjeje dhe seksionet: 2 (Përfaqësimi i pikëpamjeve të IFC-së dhe përdorimi i emrit, shenjave dhe logove të IFC-së); 3 (Mospranimet); 5 (Të drejtat e pronësisë intelektuale); 8 (Përfundimi); dhe 9 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve), në këtë aneks.

9. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Palët marrin përsipër të përpiqen me vullnetin e tyre të mirë të zgjidhin të gjitha konfliktet dhe mosmarrëveshjet, të cilat lindin si rezultat apo në lidhje me këtë Marrëveshje me anë të zgjidhjeve

miqësore.

b) Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, të gjitha mosmarrëveshjet, që lindin si rezultat apo në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht nga Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (Rregullat) nga një ose disa arbitra të caktuar sipas rregullave. Vendi i arbitrazhit do të jetë Londra dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

c) Klienti njeh dhe bie dakord që asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje ose e Rregullave, as nënshtrimi ndaj Arbitrazhit nga IFC-ja, në ndonjë mënyrë përbën apo nënkupton heqje dorë, mospranim, përfundim apo modifikim nga ana e IFC-së e privilegjeve të IFC-së, imunitetit apo përjashtimeve të mundësuara në nenet e Marrëveshjes së IFC-së ose sipas konventës ndërkombëtare ose ligjeve të zbatueshme.

10. Amendimet

Çdo amendim, heqje dorë ose çdo miratim i dhënë sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim dhe në rastin e amendimeve, këto do të jenë të vlefshme vetëm nëse nënshkruhen nga Palët.

11. Pasardhësit dhe drejtmarrësit

Kjo Marrëveshje lidh dhe është në përfitim të pasardhësve dhe drejtmarrësve përkatës të Palëve, me kusht që asnjë nga Palët të mos marrë përsipër këtë Marrëveshje, në tërësi apo pjesërisht, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.

ANEKSI B
PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

A. Shërbimet e Konsulencës. Me përjashtim të rastit kur Klienti dhe IFC-ja bien dakord ndryshe dhe me shkrim, shërbimet e konsulencës do të përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:

i) Konsulenca mbi Reformat Bazuar në Tregues (IBRA)

- Mbështetja për reformën për lejet e ndërtimit përfshin: rishikimin e modelit të sapopropozuar për administrimin e lejeve të ndërtimit, si dhe ligjin për lejet e reja të ndërtimit; mbështetjen me anë të hartimit të akteve nënligjore përkatëse; punën me Agjencinë e Planifikimit të Territorit dhe kryerjen e vlerësimit teknik të platformës së teknologjisë së informacionit për përpunimin elektronik të lejeve të ndërtimit; mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga këto vlerësime.
- Mbështetje e përgjithshme për grupin e punës për të bërit biznes në ndjekjen, raportimin dhe përparimin e reformave në lidhje me treguesit e biznesit dhe më gjerë.
- Dhënien e rekomandimeve për krijimin e një sporteli të vetëm elektronik (ndërfaqe) për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve, për shërbimin që ofrohet në sportelet aktuale dhe në atë *on-line* nëpërmjet portalit qeveritar, në një fazë të mëvonshme (kjo periudhë i referohet pas Bashkimit të Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR).
- Rishikim i raportit analitik të përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në lidhje me procedurat e renditura ne raportin e të bërit biznes dhe propozim i rekomandimeve mbi riorganizimin e mëtejshëm të procedurave, në mënyrë që të përputhen me praktikat e mira botërore.

ii) Politika e investimeve (për ekonominë në tërësi)

- Mbështetje për eliminimin e pengesave ligjore dhe *de-facto* për hyrjen e investimeve të huaja dhe riorganizimin e procedurave të hyrjes;
- Mbështetje për përgatitjen e një kuadri të ri ligjor mbi investimet strategjike dhe ligjin për investimet e huaja direkte të reja;
- Krijim i një mekanizmi për të mbledhur dhe për të zgjidhur problemet e investitorëve në Shqipëri dhe ndërtim i kapaciteteve në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), për të krijuar një sistem shërbimi për investimet dhe pas investimeve, që fokusohet në zgjidhjen e problemeve të investitorëve dhe për të lehtësuar riinvestimet në vend;
- Inventarizim dhe analizim i regjimit aktual të investimeve dhe dhënie rekomandimesh për ta bërë regjimin më efektiv. Fokusim në rrjetin kyç të agrobiznesit me vlerë (përmirësim i kapaciteteve përpunuese, infrastrukturës pas korrjes);

iia) Politika e investimeve (për sektorin):

- Mbështetje teknike për përgatitjen e një plani veprimi për rritjen e konkurrueshmërisë dhe tërheqjen e investimeve në sektorin e fruta-perimeve (prodhime të freskëta dhe përpunim ushqimor) në

Shqipëri, në bashkëpunim me projektet ekzistuese dhe njohuritë e Ministrisë së Bujqësisë;

- Mbështetje për shënjestrimin e investitorëve që kanë interes për tërheqjen e investimeve në sektorin e frutave dhe perimeve;

iii) Rregulloret e biznesit (për ekonominë në tërësi dhe për sektorin në veçanti):

- Duke punuar mbi Projektin e BE-së për sigurinë e ushqimit në Shqipëri, do të punohet me Ministrinë e Bujqësisë dhe agjencitë përkatëse për të kryer një rishikim të fokusuar të rregulloreve kyçe, me qëllim që të identifikohen ndryshimet e nevojshme: 1. Të kalohet në një nivel të inspektimeve në kufi dhe të reduktimit të marrjes së mostrave bazuar në risk; 2. Të plotësohen kërkesat e licencimit/lejes/vërtetimit të hyrjes së produkteve të freskëta dhe të përpunuara të eksporteve të frutave dhe perimeve për BE-në;
- Të mbështeten agjencitë përkatëse mbi tri fazat e procesit të vlerësimit të riskut: vlerësimi i riskut, menaxhimi i riskut dhe komunikimi i riskut në lidhje me frutat dhe perimet;
- Mbështetje për Agjencinë Kombëtare të Akreditimit për të pasur të paktën një laborator reference të njohur ndërkombëtarisht për mbetjet dhe teste të tjera në lidhje me eksportin e frutave dhe perimeve në BE;
- Të mbështetet Agjencia Kombëtare e Ushqimit për arritjen e njohjes reciproke të vërtetimeve dhe të testeve laboratorike për produktet e freskëta dhe frutave e perimeve të përpunuara midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit;
- Të jepet një vlerësim i shkurtër çështjeve të konkurrencës në këtë sektor, duke përfshirë subvencionet në vendet CEFTA dhe të jepet një raport dhe rekomandime për qeverinë mbi këtë çështje;
- Të kryhet një analizë e detajuar dhe regjistrim i proceseve dhe dokumenteve të kërkuara për eksport/importin e mallrave të sektorit të frutave dhe të perimeve (të përqendruar në mallrat e freskëta dhe të përpunuara), në fazat e mëposhtme: a) paraeksport/importit të mallrave; b) në pikën e kalimit kufitar; c) gjatë transitit të brendshëm; d) në terminalet e brendshme/zyrat doganore;

iv) Qasja në treg (për ekonominë në tërësi):

- Praktikat më të mira për organizimin e agjencive sanitare dhe fitosanitare dhe doganat, meqë ato lidhen me kontrollet në kufi dhe shkëmbimin e të dhënave;
- Asistencë për zhvillimin e metodologjisë për menaxhimin e rreziqeve dhe mjete për bazën e të dhënave për Agjencinë Shqiptare të Sigurisë të Ushqimit;
- Asistencë për reduktimin e numrit të dokumenteve të kërkuara nga agjencitë kufitare sanitare dhe fitosanitare; dokumenteve të ngjashme për frutat dhe perimet sipas standardeve të BE-së;
- Asistencë për përgatitjen e listave të të gjitha produkteve të kontrolluara nga më shumë se një agjenci dhe thjeshtimin e procedurave për inspektimin/përzgjedhjen e tyre;
- Ndihmë për të lehtësuar zbatueshmërinë e Marrëveshjes dypalëshe të transitit me Kosovën, të nënshkruar në janar 2014, duke mbështetur agjencitë e ushqimit dhe doganat, që të harmonizojnë proceset e tyre dhe të bashkëpunojnë duke shkëmbyer informacion dhe duke thjeshtuar procedurat e zhdoganimit në kufi, përfshirë kontrollet e përbashkëta;
- Ndihmë për të krijuar qasje me komitetin e tregjeve, të përbërë nga të gjitha agjencitë publike, të përfshira në sektorin tregtar dhe përfaqësues të sektorit privat për të mundësuar koordinim më të mirë të politikave mbi çështjet e tregtisë si një mekanizëm formal për dialogun me sektorin privat.

Klienti duhet të njoftojë menjëherë IFC-në për çdo ndryshim të propozuar në natyrën apo qëllimin e mëparshëm të Projektit dhe për çdo ngjarje apo kusht që pritet të ketë një efekt material në përmbushjen e shërbimeve të konsulencës. Çdo ndryshim në natyrën apo qëllimin e mëparshëm të punës do të paraqitet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga Klienti dhe IFC-ja, duke parashtruar punën shtesë që do të ndërmerret dhe tarifat përkatëse në këtë aspekt.

B. Programi kohor. Me përjashtim të rastit kur Klienti dhe IFC-ja bien dakord ndryshe dhe me shkrim, IFC-ja do të përpiqet të kryejë Shërbimet e Konsulencës sipas agjendës së mëposhtme:

i) Shtator 2015 – 30 qershor 2019

Shërbimet e konsulencës, në lidhje me IBRA-në, do të fillojnë në shtator 2015 dhe do të përfundojnë deri në dhjetor 2015.

Shërbimet e konsulencës, në në lidhje me politikën dhe zhvillimin e investimeve, do të fillojnë në shtator 2015 dhe do të përfundojnë deri më 30 qershor 2019.

Shërbimet e konsulencës, në lidhje me rregulloret e biznesit, do të fillojnë në shtator 2015 dhe do të përfundojnë deri më 30 qershor 2019.

Shërbimet e konsulencës, në lidhje me qasjen e tregut, do të fillojnë në shtator 2015 dhe do të përfundojnë deri më 30 qershor 2019.

Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së Projektit do të zhvillohen aktivitete monitorimi dhe vlerësimi.

ii) Korrik 2019 – shtator 2019

Faza e përfundimit të Projektit, finalizimit të mbledhjes së të dhënave M&E dhe prezantimi i raportit përfundimtar të Klientit.

C. Bashkëpunimi i Klientit. Klienti do të zhvillojë aktivitetet e mëposhtme dhe do të sigurojë lehtësirat e mëposhtme në mbështetje të shërbimeve të konsulencës:

i) Të miratojë një vendim i cili miraton këtë Marrëveshje bashkëpunimi dhe aktivitetet e përshkruara më sipër;

ii) Të miratojë një vendim për emërimin e grupit të punës së Projektit dhe personit përgjegjës, i cili do të koordinojë të gjitha veprimtaritë e Projektit;

iii) Të miratojë një vendim ku përcaktohen institucionet përkatëse, që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Projektit, duke përcaktuar mandatet dhe proceset e tyre përkatëse në të gjitha aktivitetet e Projektit, që përmenden në rolin dhe përgjegjësitë; ky detyrim i Klientit është shumë i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të Projektit;

vi) Të sigurojë të gjitha të dhënat dhe informacionet e disponueshme dhe të duhura, të cilat nevojiten për zbatimin e suksesshëm të Projektit;

v) Të sigurojë që të zbatohen të gjitha rekomandimet ligjore të aprovuara dhe procedurale, ndryshimet, strategjitë dhe planet e miratuara gjatë Projektit;

vi) Të vërë stafin e vet në dispozicion të organizimit të seminareve, trajnimeve, tryezave të rrumbullakëta, konferencave dhe aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit;

vii) Të sigurohet që stafi i vet merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e Projektit dhe jep komentet e veta në kohën e duhur, siç kërkohet nga stafi/konsulentët e IFC-së në lidhje me raportet, amendimet ligjore ose dokumente të tjera përkatëse;

viii) Vini zyrat në dispozicion gjatë gjithë kohës për stafin e Projektit, konsulentët dhe/ose aktivitetet/seminaret që do të organizohen. Kjo do të përfaqësojë edhe kontributin e klientit në natyrë.

Ndërsa IFC-ja merr përsipër të mobilizojë të gjitha mjetet e arsyeshme në dispozicion të saj për të kryer shërbimet e konsulencës sipas afateve të caktuara; tabela e mësipërme është përgatitur në mirëbesim, duke u bazuar në informacionet aktualisht të disponueshme për IFC-në, dhe jepet mbi baza treguese, duke supozuar, që: i) Klienti dhe personeli i vet do të zbatojnë detyrat e veta përkatëse në mënyrë të kënaqshme dhe sipas afateve; dhe ii) Klienti, në çdo kohë, do të veprojë në kohën e duhur për të dhënë informacione, duke marrë vendime dhe duke siguruar mbështetjen e nevojshme siç parashtrohet këtu dhe siç do të kërkohet herë pas here nga IFC-ja.

ANEKSI C
TREGUESIT E PERFORMANCËS PËR PROJEKTIN DHE KËRKESAT PËR RAPORTIM

Tabela e mëposhtme parashtron komponentët e Projektit dhe treguesit e performancës për Projektin, bashkë me shpeshtësinë e raportimit nga Klienti për treguesit. Për çdo periudhë raportimi, Klienti duhet të përdorë këtë tabelë për t'i dhënë IFC-së rezultatet përkatëse të Projektit për atë periudhë (jo të mbledhura nga fillimi i Projektit). Duke dorëzuar këtë tabelë, të plotësuar tek IFC-ja në datat e caktuara, Klienti pranon dhe bie dakord që informacioni i siguruar mund të bëhet publik nga IFC-ja, sipas aksesit në politikën e informacionit.

Komponenti i Projektit	Treguesi i performancës	Mund të bëhen publike? Po ose Jo	Rezultatet për periudhën e raportimit	Data ose shpeshtësia e raportimit
Rregulloret e biznesit dhe infrastruktura e cilësisë	Numri i ligjeve/rregulloreve/ ndryshimeve/kodeve të rekomanduara, të shpallura ose të miratuara	Po/Jo		Çdo gjashtë muaj (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Rregulloret e biznesit dhe infrastruktura e cilësisë	Numri i procedurave/politikave/ praktikave/standardeve të rekomanduara, të përmirësuara ose të hequra	Po/Jo		Çdo gjashtë muaj (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Rregulloret e biznesit dhe infrastruktura e cilësisë	Numri i firmave që përfitojnë nga kërkesa licencimi të reformuara	Po/Jo		Çdo gjashtë muaj (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Qasja në treg	Numri i ligjeve/rregulloreve/ ndryshimeve/kodeve të rekomanduara të shpallura ose të miratuara	Po/Jo		Çdo gjashtë muaj (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Qasja në treg	Numri i procedurave/politikave/ praktikave/standardeve të rekomanduara të përmirësuara ose të hequra	Po/Jo		Çdo gjashtëmujor (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Qasja në treg	Numri i firmave që përfitojnë nga shërbime kufitare/doganore të përmirësuara	Po/Jo		Çdo gjashtëmujor (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Politikat dhe nxitja e investimeve	Numri i ligjeve/rregulloreve/ ndryshimeve/kodeve të rekomanduara të shpallura ose të miratuara	Po/Jo		Çdo gjashtëmujor (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Politikat dhe nxitja e investimeve	Numri i procedurave/politikave/ praktikave/standardeve të rekomanduara, të përmirësuara ose të hequra	Po/Jo		Çdo gjashtëmujor (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Politikat dhe nxitja e investimeve	Numri i firmave që investojnë	Po/Jo		Çdo gjashtëmujor (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Të gjithë komponentët	Kursime të drejtpërdrejta të shpenzimeve të ligjshme	Po/Jo		Çdo gjashtëmujor (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)
Të gjithë komponentët	Investim i lehtësuar	Po/Jo		Çdo gjashtëmujor (çdo 30 qershor dhe 31 dhjetor)

ANEKSI D
DOKUMENTI I IFC-së PËR INFORMACIONIN E PROJEKTIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS (IPSHK)

Pasqyra e përgjithshme

Numri i Projektit	600476
Emri i Projektit	Projekti për Klimën e Investimeve dhe Konkurrueshmërinë e Agrobiznesit për Ballkanin Perëndimor

Statusi	Aktiv
Rajoni	Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, FYR Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia)
Vendi kryesor	Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, FYR Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia)
Vende të tjera	Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, FYR Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia)
Linja kryesore e biznesit	Klima e biznesit, Grupi Global për Tregti dhe Konkurrueshmëri
Data e vlerësuar e fillimit të Projektit	Shtator 2015
Data e vlerësuar e përfundimit të Projektit	Shtator 2019
Fondet e vlerësuara në total të menaxhuara nga IFC-ja	Për Shqipërinë, fondet e llogaritura janë 1,730,000 $
Data e miratimit nga IFC-ja	Korrik 2014
Miratuar për t'u publikuar më:	Korrik 2014
Ndikimi i zhvillimit që pritet si informacion publik	Ky Projekt do të kontribuojë në lehtësimin e investimeve (në shoqëri private, agregate etj.) në rajon dhe do të rrisë konkurrueshmërinë e shoqërive të vogla dhe të mesme (SME), duke ulur koston e operacioneve të biznesit dhe nëpërmjet kursimeve të sektorit privat nga reformat e lehtësimit të tregtisë dhe rritje të qasjes në tregun e BE-së, duke arritur të mundësojnë eksport në një sektor të ri në të paktën njërin prej vendeve të rajonit (mundësisht produktet e qumështit) deri në përfundimin e Projektit.
Përshkrimi i Projektit për informacion publik	Ky është Projekt rajonal dhe do të zbatohet në nivel shteti. Projekti do të përfshijë tre komponentë të ndërlidhur, që trajtojnë: 1. Qasjen në treg; 2. Rregullat e biznesit dhe infrastrukturën e cilësisë; dhe 3. Lehtësimin dhe politikat e investimeve. Projekti do ta fokusojë punën në Shqipëri, Bosnjë, Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Aktivitetet e Projektit do të kenë karakter rajonal, megjithëse për secilin vend do të zbatohet një listë aktivitetesh specifike, siç do të bihet dakord me qeveritë, të cilat do të përfshihen në Marrëveshjen e Këshillimit. Aktivitetet nuk do të jenë sporadike, por do të jenë aktivitete rajonale në nivel vendi që do të trajtojnë çështje rajonale të rëndësishme. Marrëveshja e Këshillimit do të mbulojë të gjitha aktivitetet për secilin vend për të gjithë komponentët. Në këtë mënyrë, ne propozojmë zgjidhje të integruara për secilin vend, duke trajtuar çështje kyçe dhe duke bashkërenduar aktivitetet përkatëse nga secili komponent.

Rezultatet e treguesve

Komponenti i Projektit	Treguesi	Kumulativ
Rregulloret e biznesit dhe infrastruktura e cilësisë	Numri i ligjeve/rregulloreve / ndryshimeve/kodeve të rekomanduara, të shpallura ose të miratuara	Nuk është e disponueshme
Rregulloret e biznesit dhe infrastruktura e cilësisë	Numri i procedurave/politikave/ praktikave/standardeve të rekomanduara, të përmirësuara ose të hequra	Nuk është e disponueshme
Rregulloret e biznesit dhe infrastruktura e cilësisë	Numri i firmave që përfitojnë nga kërkesa licencimi të reformuara	Nuk është e disponueshme
Qasja në treg	Numri i ligjeve/rregulloreve / ndryshimeve/kodeve të rekomanduara, të shpallura ose të miratuara	Nuk është e disponueshme
Qasja në treg	Numri i procedurave/politikave/ praktikave/standardeve të rekomanduara, të përmirësuara ose të hequra	Nuk është e disponueshme
Qasja në treg	Numri i firmave që përfitojnë nga shërbime kufitare/doganore të përmirësuara	Nuk është e disponueshme
Politikat dhe nxitja e investimeve	Numri i ligjeve/rregulloreve / ndryshimeve/kodeve të rekomanduara, të shpallura ose të miratuara	Nuk është e disponueshme
Politikat dhe nxitja e investimeve	Numri i procedurave/politikave/ praktikave/standardeve të rekomanduara, të përmirësuara ose të hequra	Nuk është e disponueshme
Politikat dhe nxitja e investimeve	Numri i firmave që investojnë	Nuk është e disponueshme
Të gjithë komponentët	Kursime të drejtpërdrejta të shpenzimeve të ligjshme	Nuk është e disponueshme
Të gjithë komponentët	Investim i lehtësuar	Nuk është e disponueshme

Rreziqet mjedisore dhe sociale

Standardi i performancës	Përshkrimi dhe ndikimi i mundshëm	Minimizimi
PS 1. Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale	Si pjesë e kontrollit nga IFC-ja dhe bazuar në politikën e qëndrueshmërisë së IFC-së, ekipi i IFC-së ka kontrolluar këtë Projekt për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet e performancës së IFC-së. Parimet e standardeve përkatëse të performancës janë zbatuar për zhvillimin e Projektit. Rreziqet mjedisore dhe sociale do të vazhdojnë të vlerësohen gjatë kohëzgjatjes së Projektit.	Konsulenca e IFC-së do të jepet në një mënyrë që është e pajtueshme me parimet e standardeve përkatëse të performancës. Ekipi i IFC-së do ta ndihmojë klientin, si vendimmarrës përfundimtar, për të kuptuar mirë standardet e performancëstë IFC-së dhe do të japë rekomandime për masa të përshtatshme për minimizimin e rreziqeve, kurdoherë që të jetë e nevojshme.